



A.nr. 321/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani- anëtarë, me Avdyll Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurën sipas ankesës A.nr.321/2026, të datës 23.03.2026, të parashtruar nga ankuesi V.N, nga Prishtina, kundër organit të punësimit/Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, në çështjen juridike “*Masë disiplinore*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 20.05.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.321/2026, e datës 23.03.2026, e parashtruar nga ankuesi, V.N.

II. Mbetet në fuqi Vendimi me shifër KD:Nr.03/2026, i datës 23.02.2026, i Komisionit Disiplinor të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesi V.N (*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi*), më datë 23.03.2026, përmes postës dhe përfaqësuesit të autorizuar, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjën A.nr.321/2026 dhe numër protokollit 1426/2026, kundër Vendimit me shifër KD/Nr.03/2026, të datës 23.02.2026, të Komisionit Disiplinor të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 26.03.2026 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën të Këshillit Prokurorial të Kosovës, ndërsa kjo e fundit më datë 03.04.2026, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit, me datë 05.05.2026 ka nxjerrë Vendimin me shifër VK/2025 dhe numër protokolli:2174/2026, përmes të cilit ankesës së ankuesit nën shenjën A.nr.321/2026 të datës 23.03.2026 ia ka vazhduar afatin e vendimmarrjes edhe për dhjetë (10) ditë të tjera, ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritorë administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 1426/2026 të datës 23.03.2026, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me shifër KD/Nr.03/2026, të datës 23.02.2026, të Komisionit Disiplinor; Formulari i regjistrimit të ankesës i datës 23.03.2026; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 26.03.2026; Përgjigje në ankesë e datës 02.04.2026; Akt Emërimit e ankuesit të datës 01.08.2026; Kërkesa për iniciimin e procedurës disiplinore e datës 03.02.2026; Regjistri i hyrjeve në punë për ankuesin; Shkresë e datës 29.01.2026; E-mailin e datës 21.01.2026; Vendimin me shifër KD/Nr.11/2025, të datës 27.11.2025, të Komisionit Disiplinor; Vendimin me shifër KD/Nr.02/2024 të datës 31.01.2024, të Komisionit Disiplinor; Kërkesë e datës 12.01.2024; Procesverbalin e seancave të komisionit disiplinor i datës 18.02.2026; Ftesën për seancën e Komisionit Disiplinor të datës 11.02.2026; Vijueshmëria në punë e muajt janar 2026; E-mailin e datës 19.02.2026 dërguar nga R.K për Komisionin Disiplinor; E-mailin e datës 19.02.2026 dërguar nga B.O për Komisionin Disiplinor; Vendimin e Komisionit Disiplinor të datës 31.01.2024; Kërkesën e datës 12.01.2024; E-mailin e datës 11.11.2025 dërguar nga ankuesi për B.L; Kërkesën e datës 21.10.2025; Shkresën e datës 29.01.2026 lidhur me vlerësimet e stafit; Njoftimin e datës 21.01.2026.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankueses, **është e pabazuar**, sepse:

Nga analizimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit konstatoi se ankuesi sipas Akt Emërimit me numër: 1675/2024, të datës 01.08.2024, mban pozitën “Zyrtar për linjën ndihmëse” në Zyrën për Mbrojtjen e dhe Ndhmën e Viktimave/Prokurori i Shtetit në kuadër Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, ndërsa ndaj të njëjtit udhëheqësi i tij i drejtpërdrejtë me datë 03.02.2026 kishte iniciuar procedurën disiplinore kryerjen e shkeljeve të rënda disiplinore që lidhen me mos respektimin e vendit të punës dhe mos përmbushjen e detyrave të punës.

Komisioni Disiplinor i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, pas zhvillimit të procedurës disiplinore, respektivisht pas mbajtjes së seancës me ankuesin, çështje kjo e dëshmuar edhe përmes procesverbalit të datës 18.02.2026, ankuesit përmes Vendimit me shifër KD:Nr.03/2026, i datës 23.02.2026 ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore “*Pezullim nga pozita me ndalim deri në pesëdhjetë për qind (50%) të pagës bazë, deri në tre (3) muaj*”, ngase të njëjtin e kishte gjetur përgjigjes për shkelje të rënda disiplinore të përcaktuar si në nenin 56 paragrafi 4 nën paragrafi 4.1, 4.2, 4.3, 4.5 dhe 4.11 të Ligjit Nr.08/L-198 ku përcaktohet se: “*4.1. mospërmbushja e detyrave të punës; 4.2. neglizhencë e vazhdueshme në përmbushje të detyrave të punës; 4.3. mosrespektimi i afateve të caktuara për përmbushjen e detyrave të punës; 4.5. veprimet apo mosveprimet që kanë shkaktuar pasoja, dhe 4.11. përsëritja e shkeljeve të lehta disiplinore dy (2) apo më shumë herë*”, me arsyetimin se ankuesi kishte përsëritur verimet e tij lidhur me mos respektimin e orarit të punës, çështje për të cilën kishte të shqiptuar edhe paraprakisht masë disiplinore sipas Vendimit Nr.11/2025 të datës 27.11.2025 i cili ishte bërë i ekzekutueshëm, si dhe mos përmbushjen e detyrave në kohë, lidhur me raportimin e rregullta javore në cilësinë e operatorit të linjës ndihmëse.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill kundër aktit të kontestuar pretendon se, masa e shqiptuar nga ana e Komisionit Disiplinor nuk është mbështetur në prova me arsyetimin se nuk janë marr për bazë asnjëra prej fakteve të cilat e kanë shtyrë ankuesin në gjendjen që të dal në procedurë disiplinore pranë Komisionit Disiplinor, dhe po ashtu i njëjti pretendon se kolegët e zyrës kanë sjellje jo korrekte ndaj tij, sjellje të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë në atmosferën e punës e për të cilat shpesh të herë jam menduar të parashtrojë ankesë, me kërkesën që Këshilli të aprovoi ankesën e ankuesit ndërsa të anuloi Vendimit e Komisionit Disiplinor të datës 23.02.2026.

Ndërsa në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit i'u referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 6 paragrafi 4, ku përcaktohet se : *“4. Të punësuarat/it e administratës në kuadër të sistemit të drejtësisë, Gjykatës Kushtetuese, Presidencës, Kuvendit të Republikës së Kosovës, si dhe institucioneve të pavarura kushtetuese janë nëpunës civil me status të veçantë, rregullimi i të cilëve bëhet me akt të veçantë”*, e duke marr për bazë Këshilli Prokurorial i Kosovës ka nxjerr Rregulloren Nr. 05/2024 për Procedurën Disiplinore të Stafit Administrativ në Sistemin Prokurorial të Kosovës.

Në mbështetje të këtij neni të lartë cekur, Kolegji i Këshillit përkitazi me rregullimin e procedurës dhe përgjegjësinë disiplinore të nëpunësve civil në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës ju referuar, Rregullores Nr. 05/2024 për Procedurën Disiplinore të Stafit Administrativ në Sistemin Prokurorial të Kosovës gjegjësisht:

Nenit 4 paragrafi 1, përcakton: *Stafi administrativ në SPKP mban përgjegjësi disiplinore për shket ë detyrave dhe përgjegjësi, në rastet kur nuk kryen detyrat që i janë dhënë, kur bënë zbatim jo të duhur të tyre, apo kur gjatë ushtrimit të tyre vepron në kundërshtim me aktet normative në fuqi. Shkelja disiplinore mund të bëhet me veprim apo mosveprim.*

Nenit 5 paragrafi 1, ku përcaktohet: *Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 1.1. shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 1.2. shkallën e fajësisë; 1.3. ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pafshira; 1.4. përpjekjet e mëparshme të nëpunësit për shmangien apo kufizimin e dëmit.*

Nenit 6, ku përcaktohet: *Shkeljet e detyrave dhe përgjegjësi të punë mund të jenë: 1.1, shkelej të lehta dhe 1.2. shkele të rënda. 2. Shkelje të lehta konsideroheni: 2.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune radhazi; 2.2. mosrespektimi i orarit të punës; 2.3. sjellja jo e mirë gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit, kolegët, vartësit dhe me publikun; 2.4 shkelja e kodit të Etikës Profesionale për punonjësit mbështetës të sistemit prokurorial. 3. Shkelje të rënda konsiderohen: 3.1. mos deklarim i konfliktit të interesit në rastet kur ka dijeni, 3.2. **mospërbushja e detyrave të punës**; 3.3. neglizhencë e vazhdueshme në përmbushje të detyrave të punës; 3.4. mosrespektimi i afateve të caktuara për përmbushjen e detyrave të punës; 3.5. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; **3.6. veprimet apo mosveprimet që kanë shkaktuar pasoja**; **3.7. shkelja e rregullave të përcaktuara në kodin e etikës**; **3.8. sjellje e papërshtatshme që dëmton reputacionin e shërbimit prokurorial**; 3.9. vënia në lajthitje e sistemit prokurorial përmes dhënies së informatave të gabuara ose fshehja e të dhënave zyrtare kur kërkohen për qëllime zyrtare; 3.10. përfitimi apo ofrimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale që ndodhin për shkak të detyrës; 3.11. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vazhdueshme për tri (3) ose më shumë ditë pune; 3.12. përsëritja e shkeljeve të lehta*

*disiplinore dy (2) apo më shumë herë; 3.13. moslajmërimi i shkeljeve të rënda që lidhet me detyrat e punës nga stafi administrativ i sistemit prokurorial; 3.14. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 3.15.kryerja e aktiviteteve që bien ndesh me interesat e sistemit prokurorial apo veprimet që dëmtojnë sistemin prokurorial apo organet tjera shtetërore; 3.16.Sjellaj apo kërcënimi që u pamundëson, i pengon apo u vështrojnë të tjerëve kryerjen e detyrave zyrtare të punës; 3.17.fshehja e fakteve, provave apo të dhënave zyrtare, kur ato kërkohen me qëllime zyrtare, 3.18. mosruajtja e konfidencialitetit në lidhje me informacionet që janë të rëndësishme për institucionin gjatë kryerjes së detyrave të punës; 3.19. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit dhe dokumenteve të klasifikuara; 3.20. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera narkotike të ndaluara; 3.21. përdorimi i alkoolit në vend të punës ose ardhja i dehur në punë; 3.22. keqpërdorimi i detyrës zyrtare lidhur me procedurën e rekrutimit nga anëtarët/ët e komisionit të rekrutimit që janë shërbyes civil; **3.23. ngacnimet në vendin e punës apo gjatë ushtrimit të detyrës, që cenojnë integritetin moral dhe fizik, si dhe ato seksuale;** 3.24. diskriminimi mbi baza gjinore, racore dhe të tjera, sipas ligjit përkatës kundër diskriminimit; 3.25. shkelja e detyrimeve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.*

Enit, 12 paragrafi 1: *Komision i Disiplinor ka këto kompetenca, 1.1. të shqyrtoj provat lidhur me shkeljen e supozuar, 1.2.Tëq vendos në bazë të provave nëse është kryer shkelja dhe 1.3.3 Të përcaktoj masën që duhet shqiptuar.*

Enit 17 paragrafi 3, ku përcaktohet: *Masat disiplinore për shkelje të detyrave të punës, të përcaktuar me nenin 5 të kësaj rregulloreje, stafit administrativ sistemit prokurorial mund t'i shqiptohen këto masa disiplinore: 3.1.ndalimi i njëzetë për qind (20%)deri në pesëdhjetë (50%) të pagës bazë për një periudhë deri në gjashtë (6) muaj; 3.2. ndalimi i avancimit/emërimit në kategori më të lartë, për një periudhë nga një (1) deri në pesë (5) vite; 3.3. transferimi në pozitë të ngjashme në klasë dhe kategori të njëjtë; 3.4. ulja në pozitë; 3.5. pezullimi nga pozita pa pagesë deri në gjashtë (6) muaj; 3.6. pezullimi nga pozita me ndalim deri në pesëdhjetë për qind (50%) të pagës bazë, deri në një (1) vit; 3.7. largimi nga shërbimi civil.*

Kolegji i Këshillit me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit, analizoi provat e lëndës dhe konstatoi se ankuesit për mos respektim të orarit të punës dhe mungesave në punë i ishte shqiptuar paraprakisht masë disiplinore përmes Vendimit nr.2107/2025 të datës 27.11.2025, i cili ishte bërë i ekzekutueshëm, madje ankuesi në seancën e procedurës disiplinore pranë Komisionit Disiplinor,sipas procesverbalit të datës 18.02.2025 e pohon faktin se ka problem lidhur me mos respektimin e orarit të punës, madje kjo çështje konstatohet edhe përmes listave të evidentimit të hyrje daljeve nga punë, e që sipas listës së evidentimit për muajin Janar të vitit 2026, konstatohet fakti se i kishte gjithsejtë 18 lajmërimet apo hyrje në punë, prej të cilave vetëm në dy rastet kishte shkuar më herët në punë, ora 07:54 dhe 07:53 min, kurse në 16 rastet të tjera i njëjti ishte vonuar apo ishte lajmëruar në punë pas orës 8, kurse gjatë tërë muajit vetëm në një rast kishte bërë dalje apo ishte evidentuar me rastin e daljes nga puna, përderisa me rregulloren përkatëse, respektivisht me nenin 25 paragrafi 1 dhe 2 të Kodit të Elitës Profesionale për Punonjësit Mbështetës me Nr. 914/2022 të datës 10.08.2012, ku përcaktohet: *1. Stafit do të respektoj orarin e punës së zyrës përkatëse. 2. Gjatë orarit të punës Stafit do të kryejnë vetëm veprimtaritë që ndërlidhen me zyrën.*

Po ashtu, nga analizimi i shkresave të lëndës lidhur e arsytimit e ankuesit se i njëjti nuk i ka përmbushur detyrat e punës apo nuk ka kryer raportimet e nevojshme javore, për shkak të problemeve me mosfunksionimin e kompjuterit si dhe qasjes nga kolegët e zyrës, Kolegji i Këshillit vlerëson se pretendimet e tilla nuk janë mbështetur me asnjë provë relevante, gjegjësisht të njëjtat nuk janë të bazuara pasi që sipas dëshmive të ofruara nga organi punëdhënës, gjegjësisht komisioni disiplinor të cilët sipas shqetësimeve të ngritura nga ankuesi, i janë drejtuar me kërkesa zyrtarëve të IT-së në kuadër të SKPK-së, për të dhënë sqarime të nevojshme lidhur me pretendimin e ankuesit nëse ka pasur probleme me funksionimin e kompjuterit, ndërsa të njëjtit përmes e-mailit të datës 19.02.2026 i janë përgjigjur komisionit disiplinor se kompjuteri i tij është funksional për përmbushjen e detyrave të punës, kurse në 80% rasteve të raportuara nga ankuesi lidhur me funksionimin e kompjuterit të tij, problemet janë shfaqur në pamundësinë e kyqjes në kompjuter për shkak se ankuesi ose e ka harruar fjalëkalimin ose e ka shtypur të njëjtin gabimisht, ndërsa lidhur me atmosferën e krijuar në zyrë apo qasjen e kolegëve të tij sikurse ankuesi pretendon, Kolegji i Këshillit thekson faktin se për një çështje të tillë ankuesi nuk ka mundur ta mbështesë me asnjë provë relevante, ndërsa për çështje të ngjashme ankuesi mund të ndjek procedurat e brendshme, të lajmërimit të eprorët apo komisioni disiplinor në formë të shkruar, sikurse përcaktohet me ligjin material.

Prandaj, duke marrë për bazë dispozitat e aplikuara nga neni 31 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, ku përcaktohet se: “1. Zyrtarja/i publik duhet të ushtrojë detyrën e saj/tij me përgjegjshmëri dhe mban përgjegjësi të plotë sipas legjislacionit në fuqi, për çdo veprim apo mosveprim të saj/tij në kuadër të detyrave dhe përgjegjësi. 2. Zyrtarja/i publik është e detyruar të shfrytëzojë orarin e punës me efikasitet dhe vetëm për kryerjen e detyrave të saj/tij të punës”, ndërlidhur me nenin 55 paragrafi 1 i të njëjtit ligj ku përcaktohet se: “1. Nëpunësja/i civil mban përgjegjësi disiplinore për shkelje të detyrave dhe përgjegjësi, në rastet kur nuk kryen detyrat që i janë dhënë, kur bën zbatim jo të duhur të tyre apo kur gjatë ushtrimit të tyre vepron në kundërshtim me Kushtetutën, ligjet dhe akte të tjera nënligjore në fuqi. Shkelja disiplinore mund të bëhet me veprim apo mosveprim”, si dhe konstatimet e dhëna si më lartë në arsytimin e këtij vendimi, Kolegji i Këshillit konstatoi se ankesa e ankuesit është e pabazuar dhe e njëjta është refuzuar si në dispozitivin e këtij vendimi, ndërsa akti i kontestuar është lënë në fuqi pasi që i njëjti është nxjerrë në procedurë të rregullt administrative, si dhe është në pajtueshmëri me dispozitat e LPPA-së si dhe dispozitat e ligjit material, respektivisht Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik.

Theksuar si më sipër dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda:A.nr.321/2026, datë 20/05/2026

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetari i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit V.N;
- Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës (Drejtorit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore), si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së